



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 169 prot.

Kamëz, më 17.12.2024

VENDIM

Nr 121 Datë 19/12 /2024

PËR
PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PER PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2026-
2028 DHE BUXHETIN VJETOR 2026.

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.19/12/2024, pasi mori në shqyrtim Projekt- Vendimin nr.101 dt 13/12/2024, *Në mbështetje të:*

Ligjit Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në Ligjin nr 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin „Ligjit nr 68/2017 “Për Financat e vetëqeverisjes vendore ” Udhëzimit Plotësues nr.23 dt.30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Ligji nr. 10 296, dt. 08.07.2010, “Per Menaxhimin financiar dhe kontrollin“, Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022, Udhëzimin Nr. 3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2025-2027”, Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Keshilli Bashkiak

VENDOSI

1. Miratimin e kalendarit të përgatitjes se programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026, bashkëlidhur pjesë përbërese e këtij vendimi.
2. Ky Vendim i shtrin efektet nga data 01.01.2025.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut

KRYETAR I KESHILLIT
HYSEN KOLDASHI